



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 052-2170/2026

Klinë, datë: 19.01/2026

PËR: Drejtorinë e Administratës – Drejtorin, z. Binak Syla

NGA: Shërbimi për Punë të Kuvendit – Ahmet Barisha



RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KUVENDIT DHE I ZYRËS PËR PUNË TË KUVENDIT PËR VITIN 2025

1. RAPORTI I ZYRËS PËR PUNË TË KUVENDIT

Shërbimi për Punë të Kuvendit, për funksionalizimin e tij, mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, udhëzimet administrative dhe rregulloret e ndryshme të Qeverisë së RKS-së, Statutin e Komunës së Klinës, si dhe rregullore të tjera komunale.

Varësisht nga natyra e propozim-vendimeve dhe draft-rregulloreve, planeve, raporteve, strategjive etj. që parashtrihen për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, bashkëpunohet ngushtë me Zyrën Ligjore dhe Drejtoritë Komunale, Ekzekutivin.

Ky shërbim punën e vet e mbështet gjithashtu në Planin Vjetor të Punës së Kuvendit dhe të komiteteve të Kuvendit.

Shërbimi kryen përgatitjet profesionale dhe teknike për mbajtjen e seancave të rregullta të Kuvendit të Komunës, ku sipas planit të punës parashihet mbajtja e 11 seancave të rregullta gjatë vitit kalendarik.

Zyra për Punë të Kuvendit përgatit gjithashtu mbajtjen e seancave të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne të Kuvendit të Komunës.

Po ashtu, shërbimi organizon mbajtjen e mbledhjeve të komiteteve të Kuvendit: dy komitetet obligative, të cilat mbajnë nga 11 mbledhje brenda vitit, komitetet konsultative së paku 6 mbledhje, ndërsa komitetet e tjera, gjithsej 5, mbajnë mbledhje sipas nevojës.

Debatet me publikun mbahen sa herë që paraqiten për debat projekt-rregullore, plane apo strategji të ndryshme.

Gjatë vitit kalendarik 2025, ky shërbim ka përgatitur punën për mbajtjen e gjithsej 8 seancave të rregullta të Kuvendit. Janë bërë përgatitjet për këto seanca duke koordinuar hartimin e pikave të rendit të ditës dhe përgatitjen e materialeve, në bashkëpunim me drejtoritë komunale dhe Zyrën Ligjore.

Gjatë seancave të Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete mbahen procesverbale, të cilat publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Aktet e tjera të miratuara janë protokolluar brenda afatit prej 7 ditësh dhe i janë dërguar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për konfirmim të ligjshmërisë, Arkivit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës. Pas konfirmimit të ligjshmërisë, aktet i janë dërguar Zyrës për Informim për publikim në ueb-faqen zyrtare, me ç'rast bëhen të plotfuqishme.

Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe janë mbajtur kontakte pune me MAPL-në, Asociacionin e Komunave të Kosovës, Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit dhe Drejtorin e Administratës. Gjithashtu, janë dërguar raporte tremujore për MAPL-në.

3. KOMITETET OBLIGATIVE

Ky shërbim ka përgatitur punën për mbajtjen e dy komiteteve obligative:

- Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF);
- Komiteti për Komunitete (KPK).

Komiteti për Politikë dhe Financa

Ky komitet ka mbajtur gjithsej 10 seanca të rregullta. Ka shqyrtuar të gjitha kërkesat, draft-rregulloret, draft-planet dhe draft-strategjitë.

Janë bërë të gjitha përgatitjet bazuar në pikat e rendit të ditës të propozuara nga Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës dhe drejtoritë komunale, duke respektuar Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, udhëzimet administrative, rregulloret komunale dhe Planin e Punës së Kuvendit dhe komiteteve.

Përgatitjet kanë përfshirë caktimin e rendit të ditës, kompletimin dhe shumëzimin e materialeve, si dhe sigurimin e lektorimit dhe përkthimit sipas mundësive. Materialet për Kuvendin dhe KPF-në dërgohen vetëm në formë elektronike.

Janë mbajtur procesverbale gjatë mbledhjeve, të cilat janë protokolluar, dërguar për publikim në ueb-faqe dhe ruhen në këtë shërbim. Janë përgatitur rekomandime për pikat e rendit të ditës, të cilat janë bartur për shqyrtim në Kuvend.

Komiteti për Komunitete

Ka mbajtur 8 seanca të rregullta.

4. KOMITETET KONSULTATIVE

- Komiteti për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit – nuk ka mbajtur asnjë takim;
- Komiteti për Çështje Emergjente – nuk ka mbajtur asnjë takim;

Arsyeja e mos mbajtje së mbledhjeve ka qenë mos pagesa e anëtarëve pasi që nuk është paraparë me ligjin për pagat në sektorin publik.

5. KOMITETET E TJERA

- Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport – 0 takime;
- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – 0 takime;
- Komiteti për Shërbime Publike – 0 takim;
- Komiteti për Pronë – 0 takime;
- Komiteti për Planifikim Urban, Ekonomi dhe Zhvillim – 0 takime.

Arsyeja e mos mbajtje së mbledhjeve ka qenë mos pagesa e anëtarëve pasi që nuk është paraparë me ligjin për pagat në sektorin publik.

6. KËSHILLI PËR SIGURI NË BASHKËSI

Këshilli për Siguri në Bashkësi ka mbajtur gjithsej 6 takime të rregullta, sipas planit të punës së KKSB-së.

7. DEBATET ME PUBLIKUN

Gjatë vitit 2025 janë mbajtur gjithsej 2 debate me publikun nga Kuvendi i Komunës.